



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: Sistem kondicionimi stacionar për pjesën lindore të ARRSH-së (blerje dhe instalim kondicionerë stacionarë)

Në buxhetin e vitit 2024, janë planifikuar fondet për objektin: "Sistem kondicionimi stacionar për pjesën lindore të ARRSH-së (blerje dhe instalim kondicionerë stacionarë)".

Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, Nr. 100, Datë 17.04.2024, përvlerësimin dhe llogaritjen e fondit limit, hartimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për objektin "Sistem kondicionimi stacionar për pjesën lindore të ARRSH-së (blerje dhe instalim kondicionerë stacionarë)", ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm teknikoekonomik (relacion teknik dhe preventiv) për këtë objekt.

1. Gjendja ekzistuese

Ndërtesa e Autoritetit Rrugor Shqiptar ndodhet pranë digës së Liqenit Tiranë, në pjesën lindore të qytetit të Tiranës, Njësia administrative Nr.5, rruga "Sami Frashëri".




ARRSH disponon në pjesën perëndimore sistem kondicionimi stacioner realizuar në vitin 2020, bashkëkohore të përshtatshme dhe funksionale për nevojat e punës. Në pjesën lindore të ndërtesës ka të instaluar kondicioner monosplit (individual) të cilët janë instaluar mbi 10 (dhjetë) vite më parë dhe nuk funksionojnë me efikasitetin e tyre të plotë, për rrjedhojë performanca e tyre është e ulët, kanë probleme teknike të përsëritura si dhe konsum të lartë të energjisë pasi janë njësi të vjetra. Duke marrë shkas nga sa mësipër lindra nevoja për zëvendësimin e tyre me njësi të reja sipas teknologjive bashkëkohore.

Me poshtë disa fotografi të gjendjes ekzistuese







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

2. Ndërhyrja konsiston në punime të tilla:

Zëvendësimi I kondicionerëve përfshin disa lloj punimesh teknike dhe strukturore për të siguruar instalimin e duhur të njësive të reja dhe funksionimin efikas të sistemit.

Çmontimi I njësive të brendshme dhe të jashtme të pajisjeve të vjetra duke përfshirë heqjen e sigurt të pajisjeve, tubave dhe ftohësve.

Kondicionerët e rinj kërkojnë përmirësimin e furnizimit me energji elektrike që do të thotë përditësimi I instalimeve elektrike, si dhe kontrolli I kanalizimeve.

Instalimi I kondicionerëve të rinj konsiston në vendosjen e njësive të brendshme dhe të jashtme, lidhjen e tubave dhe linjave elektrike.

Gjithashtu ndërhyrja konsiston në instalimin e rrjetit elektrik në UPS qendror për të siguruar furnizim të qëndrueshëm të energjisë.

Hapi i fundit është testimi i pajisjeve, sistemit dhe kalibrimi i tyre.

3. Qëllimi

Qëllimi i zëvendësimit të pajisjeve të vjetra me të reja konsiston në përmirësimin e e performances, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit të ajrit të kondicionuar.

Avantazhet me kryesore janë:

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke ulur ndjeshëm kostot e operimit dhe kërkojnë më pak energji duke rezultuar në një ndikim pozitiv në kursimet afatgjata.

Modelet e reja të njësive kanë sisteme të përmirësuara për filtrimin e ajrit dhe kontrollimin e lagështisë, duke përmirësuar cilësinë e ajrit brenda ambienteve.

Zhurma më e ulët gjatë funksionimit të pajisjeve.

Njësitë e reja kanë kosto më të ulët për mirëmbajtje dhe riparim, kanë jetëgjatësi më të madhe gjithashtu përdorin teknologji më të avancuara.

Afati i realizimit të punimeve 12 (dymbëdhjetë) javë.

Bashkëngjitur Specifikimet Teknike dhe Preventivi i Punimeve

Grupi i punës

Nikollaq Mihali

Astrit Zenelaj

Altin Sula

